A.K.A/F.P.K.
Nr. 13/1 Prot.
Datë,më 02.03.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT, AFTËSIMIT DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE

Nr. 265/1 Prot. Tiranë, më 26/02/2026

U R DH Ë R

Nr. 141, Datë 26.02 2026

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT PËR MËSIMDHËNËSIT NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 24 të nenit 4, shkronjës h, të nenit 7 të ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, shkronjës b të pikës 4, shkrojës c të kreut II, të Vendimit nr. 673, datë 16.10.2019, të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve",

URDHËROJ:

1. Miratimin e programit të trajnimit për mësimdhënësit në arsimin profesional, "Bazat e didaktikës në arsimin dhe formimin profesional", sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhëri.

2. Certifikimi i mësimdhënësve do të bëhet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

3. Ngarkohen, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe ofruesit publikë e jopublikë të arsimit dhe formimit profesional, për zbatimin e këtij urdhëri.

4. Urdhëri nr. 240 datë 14.01.2021, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për programin e kursit të trajnimit për mësimdhënësit në arsimin dhe formimin profesional, "Bazat e Didaktikës në AFP", shfuqizohet.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Delina Ibrahimaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT - TIRANË